

LULJETA BORA – BEJLERI

**POLISEMANTIKA E SHPREHJES SË FIGURSHME TË ARAPIT
NË KRIJIMTARINË E TIJ POETIKE TË VITEVE '80**

Abstrakt

Poezia e Arapit mbeti poezia e kërkimit të përhershëm, larg skematizmit, gjithmonë drejt spontanitetit, duke u përfaqësuar si një nga krijimtaritë e pakta thellësisht origjinale të viteve '80. Ajo u përpoq vazhdimisht t'i largohet frymës kolektive të optimizmit. I kritikuar në vitin 1973 për vëllimin poetik "Më jepni një emër", F. Arapi ra në heshtje për një farë kohe. Duke lënë mënjane ribotimin e poezive të së kaluarës (1983) dhe debutimin herë pas here në organet letrare, poezia e viteve '80 e tij, kulmoi me vëllimet "Duke dalë prej ëndrrës" (1989) dhe "Ku shkoni ju statuja" (1990). Këto dy vëllime, botuar njëri pas tjetrit, erdhën si projektim filozofik i unit lirik.

E gjithë poezia e Arapit përshkohet nga raporte mes abstraktes e konkretes, nga një frymë filozofie e intelektualiste, jo fort e thjeshtë për lexuesin e këtyre viteve. Me gjithë ndonjë refleksion ideologjik për të mbrojtur poezinë dhe të drejtën e botimit, apo autocensurës si pasojë e kritikave të forta, poezia e Arapit mbeti po në të njëjtën linjë *heronjsh e shtatoresh*, *ullinjsh të heshtur si murgj, perëndi, gjak* dhe verë të cilët përcjellin frymë shenjtërie. Ëndrra e tij surrealistë, veç si ëndërr e dashurisë, erdhi si alegori e përsosjes morale, rendje drejt shpirtit të tejdukshëm, si drejt heroit moral të njerëzimit. Leximi mes pjesëve të shkëputura, apo mes elementeve që pasqyrojnë angazhimin, nuk do t'ia ulte vlerën e përgjithshme poezisë, ashtu sikur s'do të mundë të fshihte humanizmin e besimin në projektimin e një botë më të mirë njerëzore.

Ka shkrimtarë që do të admirohen gjithmonë, por ka edhe nga ata të cilët i ndjek harresa, por mes një poezie që i mbijetoi kohërave, Arapi, ashtu sikurse Agolli e Kadare, do të mbetet *flaka e vjetër* e një zjarri që nuk u shua dot.

Fjalë kyçe: *Arap, poezi filozofike, polisemantikë e figurës.*

Poezia e Arapit mbeti poezia e kërkimit të përhershëm, larg skematizmit, gjithmonë drejt spontanitetit, duke u përfaqësuar si një nga krijimtaritë e pakta thellësisht origjinale të viteve '80. Ajo u përpoq vazhdimisht t'i largohet frymës kolektive të optimizmit. *Më lodhi avalanshi i figurave poetike. Qenka shumë e vështirë t'i thush botës/diçka të kthjellët/të vogël*¹, deklarata e tij poetike për një tjetër lloj poezie, kryesisht në përmbajtje, të kujtojnë pashmangshmërisht Poradecin (*Këngë e lashtë e vjershërimit më pëlqeu aq fare pakë/*). Ndoshta, mjaftojnë edhe këto dy vargje për të dëshmuar pjekurinë letrare gjithnjë në rritje të këtij autori².

I kritikuar në vitin 1973 për vëllimin poetik "Më jepni një emër", F. Arapi ra në heshtje për një farë kohe. Duke lënë mënjanë ribotimin e poezive të së kaluarës (1983) dhe debutimin herë pas here në organet letrare, poezia e viteve '80 e tij, kulmoi me vëllimet "Duke dalë prej ëndrrës" (1989) dhe "Ku shkoni ju statuja" (1990), ku u përfshinë si të ribotuara pesë nga poezitë e tij botuar tek vëllimi poetik "Më jepni një emër" (*Ku shkoni ju statuja, Qenka e vështirë, Ëndrra të mia, Dashuritë janë të shumta*). Vëllimet në fjalë janë shkruar në autocensurë nga ai, por gjithsesi talenti e tejkalon autocensurën.

Këto dy vëllime, botuar njëri pas tjetrit, erdhën si projektim filozofik i unit lirik. Vendlindja, atdheu, dashuria, mitet, janë indet e ligjërimit poetik të Arapit. Njerëzorja është paradigma e verbit të tij poetik. Dialogu i tij poetik ka kaq besueshmëri ashtu sikurse dhimbja e humbjes, trishtimi i mungesës dhe sakrificës, dëshirës dhe mosarritjes. Pak ironik e njerëzor verbi i Arapit sentencial dhe tradicional, ndërtoi edhe në vitet në fjalë një poezi intelektuale që kulmoi veçanërisht me meditimin dhe bisedat intime. Tokësor, i prekshëm po aq sa edhe filozofik, mes vargjeve të rënda meditative, Arapi ndriçoi në honin e thellë të ndërgjegjes shenjtërinë e vlerave njerëzore mes të cilës heroi lirik gjen motiv dhe forcë të ecë.

Monologët, mbeten elementet që shpalosin përvojën e vetëdijshme të unit lirik (*Jam një pikë diellore/lëshuar pingul/gjireve të thella t'oqeanit të jetës*³), i cili veç të tjerash zbulon tek vetja mëkatin në përmasa përgjithësuese (*Ah liri.../ (...) dy gisht nën cipën tënde gërvisht/ dhe*

¹ "Ku shkoni ju statuja" (1990) f. 5.

² Kriteri letrar na mundëson që, duke dhënë gjykimin mbi një vjershë si e tillë, të përpiqemi për të përcaktuar vendin/peshën e saj në krijimtarinë e autorit, në një periudhë letrare të caktuar.

³ F. Arapi, "Ku shkoni ju statuja" (1990), *Hipokrizi nuk je e bukur*, f. 19.

*tragjeditë e tua takoj.../ Të tuat, / apo të miat?*⁴), (*Përse paskam frikë t'i afrohem detit?*)⁵. Siç edhe shihet nga vargjet, tek poezia e Arapit ka figura të perspektivës poetike. Kalimi nga plani individual në atë universal dallohet si një prirje. Uni lirik i kësaj poezie aspirojnë të identifikohet me dhimbjen dhe disfatën e njerëzimit dhe kjo vjen si një vetëdije e shpallur. (*Ëndrra ju jeni të rënda (...) Ju ngaroni mbi mua kafshimet e urive, / Fytyrat e përgjakura, e të dhembshura të lirive; / ju ngarkoni mbi mua varrezat e dëshmorëve / të të gjitha kohëve, / të të gjithë popujve*⁶. Kjo tendencë e fortë përgjithësuese, merr nota universale kur synon të thotë diçka me vlerë të sentencës: *Ah, Lir... Përse këto eshtra të tuat / më qenkan bërë prej ngashërimesh,-/ kush i dëgjoi njëherë / s'i harron dot më kurrë.* (1981)⁷ Ligjërimi poetik, ndonjëherë plot kritika e autokritika, shndërrohet në ligjërim të ngrohtë të dhimbjes shkaktuar nga trishtimi për mosarritjen e aspiratave, por sidomos në dhimbje të thellë për njeriun; s'ka lumturi, s'ka të fituar kur sakrifikohen shpirta njerëzorë.

Agimet e zjarra, agimet e mëdha përbëjnë njëkohësisht edhe patosin e poezisë së Arapit, megjithatë në një realitet ku ka shumë slogane, varfëri, eufori pllakateske, i nxitur nga ndjeshmëria humane, uni lirik vë re përplasjen e së drejtës me të padrejtën, e shpresës me zhgënjimin, e të vjetrës me të renë, e së keqes me të mirën dhe sugjeron qëndresën (*Hipokrizi, nuk je e bukur, (...) vetëm ndjesia se ti më avitesh / e vret frymëmarrjen e dritave të mia*⁸).

E gjithë poezia e Arapit, përshkohet nga raporte mes abstraktes e konkretes, nga një frymë filozofie e intelektualiste, jo fort e thjeshtë për lexuesin e kohës (*Tokë! Një herë njerë, dy herë nënë! (...) vijmë tek ty, në trupin tënd hyjmë / me jetën tonë prej rrënje / qiparizi, / ulliri / dafine- / me jetën tonë gonxhe trëndafili / të porsa çelur në zemër*⁹. Fjalët që shprehin nocione abstrakte të ngazëllimit, vetmisë, madhësisë, mes të cilave realizohet përgjithësimi artistik dhe polisemia, janë karakteristike e poezisë së tij në vazhdimësi.

⁴ *Ah liri* (1980), marrë nga vëllimi "Më vjen keq për Jagon".

⁵ *Përse paskam frikë t'i afrohem detit?*, Vëllimi "Duke dalë prej ëndrrës" (seria "Poezi të gjedhura 1962-1989").

⁶ "Ku shkoni ju statuja", 1990, f. 6.

⁷ Marrë nga vëllimi "Më vjen keq për Jagon", ku janë botuar edhe poezi të shkruara gjatë viteve '80, f. 32.

⁸ Vëllimi "Ku shkoni ju statuja" (1990), f. 19.

⁹ *Nëna*, "Duke dalë prej ëndrrës" (1989), seria *Poezi të zgjedhura*, f. 180.

Filozofia e ekzistencës individuale mes ëndrrave të Jonit, shkëmbinjve dhe tokës së vendlindjes erërave, ullinjve e shkumës së valëve deklarohen në pjesën më të madhe të poezive duke bërë të funksionojë një mekanizëm i destinit individual: përjetësisht me shpirt në vendlindjen e tij, pranë detit e të ullinjve (*Dhe ne, ullinj të gjelbër / në brigjet e detit të gjaktë të jetës. / Ne që njohim veteveten/në lavdinë tonë tragjike*¹⁰).

Detaji i ullirit tek vëllimi “Ku shkoni ju statuja” meriton një vëmendje të veçantë në poezinë e Arapit, sepse mbetet detaji me dendësi më të madhe përdorimi, por jo vetëm kjo, ulliri është gjithmonë pjesa hyjnore e poezisë së tij. Ai bëhet burim frymëzimi poetik, madje një detaj, i cili e ndjell dhe ushqen trishtimin e poetit. *Dashuri ullinjsh, muzgje ullinjsh, shpirt të ullinjte, lule ulliri, blerime dritëullirta* janë ndërtime figurative që hasen shpesh. Elementet e trishtuara, apo elementet e krishterimit, ndërfutur tek motivet filozofike, dallohen qartësisht te poezia e tij në vazhdimësi dhe herë-herë bëhen gur prove të një poezie dramatike. Duhet thënë se Arapi e ushqen trishtimin. Ai është aq burim dhimbjeje sa edhe i bukur, i admirueshëm “*Asgjë s’i trishton ullinjte. Më shumë se udhët e luftës*”¹¹.

Me gjithë ndonjë refleksion ideologjik për të mbrojtur poezinë dhe të drejtën e botimit, apo autocensurës si pasojë e kritikave të forta, poezia e Arapit mbeti po në të njëjtën linjë *heronjsh e shtatoresh*, ullinjsh të *heshtur si murgj, perëndi, gjak* dhe verë, të cilët përcjellin frymë shenjtërie. Ëndrra e tij surrealistë, veç si ëndërr e dashurisë, erdhi si alegori e përsosjes morale, rendje drejt shpirtit të tejdukshëm, si drejt heroit moral i njerëzimit.

Natyra merr pjesë gjerësisht në poezinë meditative të Arapit. *Qielli, erërat, retë e rënduara* dhe *shirat* që krijojnë copëza pasqyrash në asfalt, mbeten një grup detajesh të botës poetike të vargjeve, të cilat ushqejnë shumësi gjendjesh dhe kuptimesh, ngërthyer prej metaforash fort origjinale, të cilat nuk e humbin fuqinë edhe pse i gjejmë si të rimarra ndër poezi. Heshtja e unit lirik, ashtu sikurse meditimi i tij, i bashkëngjitet heshtjes së rëndë të qiellit që pret të shkarkojë shiun.

Grija e jetës dallohet si pjesë e pranishme e vargjeve të Arapit. Në një realitet sloganesh, ndonëse sugjeron qëndresën, uni lirik zbulon edhe

¹⁰ “Ku shkoni ju statuja”, 1990, *Pirrua*, f. 76.

¹¹ *Po aty*, f. 78.

melankolinë (*Gjelbërosh gjer në palcë si ulliri / do të punoj në veten time / ekzistenxën e dhimbshme të kohës*).

Melankolia bëhet pjesë edhe e raportit erotik. Dëshira për femrën shoqërohet nga potenciali i përjetimit dhe trishtimi i ëmbël, aq sa habia për fuqinë e pranisë, apo mungesës së saj. Ajo është dëshirë dhe dhimbje, e cila përgjithësohet si e krejt botës mashkullore (*në një pikë loti pa fund e skaj- / mbaj Dashurinë / dhe universin tragjik të saj*¹²). Dashuria e Arapit i afrohet në pika përgjërëse poezisë së Naimit, apo Lasgushit. Ajo është plot shpresa, e butë e dhembshur, e ngrohtë, pa sforco e krejtësisht e shkëputur nga zhvillime të kohës, apo pre e ideologjisë. Muzgjet e dashurive, rendjet e dashurive nëpër to u bënë pjesë e ndjesive moderne erotike, duke edukuar shijet e emancipuara të lexuesit të ri të viteve në fjalë.

Miti erdhi në vargjet e Arapit si flaka e largët e një kandili nga ku ndriçohen dyshimet ekzistenciale, ku përvoja e së shkuarës, bëhet edhe e së sotmes (*...dhe më duket sikur / brenda kraharorit të gurtë / shekulli vetë përpëlitet*).¹³ Mes mitit dhe fjalëve me konotacione antike, zbulohet drama e intelektualit, i cili reflekton. (*Çfarë kërkojmë ne në oqeanët qiellorë, / në tejqiejt e panjohur*)¹⁴. Pentesilea, Pirroja, Penelopa, Çezari, Uliksi etj. etj. figura, hyjnë si paratekste te poezia meditative e Arapit për të sjellë përgjithësisht përsëritje të përvojave të së shkuarës (*Vazhdo të endësh Penelopë / Rrahja e avlëmendit tënd / është krismë e përjetshme e valëve të Jonit / Ti mos u mërzit, mos u lodh duke pritur o grua. / Kemi nevojë për një ëndërr malli në sy*).¹⁵

Nga shqyrtimi i vargjeve, në të gjitha thellësitë që përfaqësojnë, krijimtaria e viteve '80 e Arapit përjashtohet nga letërsia shërbestare e realizmit socialist. Pavarësisht pjesëve të caktuara të krijimtarisë, të cilat mund të lidhen edhe me shkaqe jashtëletrare, krahasuar me poezinë tjetër që shkruhej në këto vite, toni ligjërimor dhe shprehësia me shkëndijimet e ngjyresave, vargu, ritmika e ligjërimit, paraqesin një poezi të vetvetishme, aq sa edhe organike, shumë të ndryshme nga poezia zyrtare, një nga tre modelet Agolli-Kadare-Arapi, e pangatërrueshme të poezisë shqipe¹⁶. Meditimi për ekzistencën sa individuale aq edhe kombëtare tek poezia e këtyre poetëve, filozofia e mbijetesës kolektive, ndërgjegjja e gjykimit të

¹² *Po aty, Moj e vogëla sa loti*, f. 36.

¹³ *Po aty*, "Ku shkoni ju statuja"..., f. 15.

¹⁴ *Po aty*, f. 59.

¹⁵ "Ku shkoni ju statuja", *Penelopës*, f. 83.

¹⁶ Studiuesi Sh. Sinani, në veprën e tij *Njerëzit e krisur të Dritëro Agollit*, i cilëson këta poetë si *profesorë të shkëlqyer të poezisë shqipe*.

lexuesit të ardhshëm, që mori formën e një testamenti poetik të tyre, ekzistenca e një grupi fjalësh që bëhen pjesë e një strukture individuale dinamike, e cila hyri në vetëdijen e studiuesve, antiteza, kontrasti si zgjedhje e poezisë së të treve dhe mjaft e mjaft pika të tjera të vlerësuar, i bëjnë këta poetë shembuj vlere për vargjet pasues të poetëve, të cilët shihnin tek ta modernitetin. Leximi mes pjesëve të shkëputura, apo mes elementeve që pasqyrojnë angazhimin e tyre, nuk do t'ia ulte vlerën e përgjithshme të poezisë, të humanizmit e besimit në projektimin e një botë më të mirë njerëzore. Të tre këta autorë u përpoqën të krijojnë një poezi të mrekullueshme të shpresave për një të ardhme të lumtur¹⁷. Të mos harrojmë se poezia e tyre, përveçse mori vlerësime, edhe e provokoi kritikën mes nënteksteve atakuese. (*Oh, që ishim të mirë ne / heroikët / ne-tragjikët. (...) E dinim që mbanim / Shpresën-pashpresë-në buzë*¹⁸). Pjesëmarrja nëpër presidiume tregon përpjekjen e kamufluar e të vazhdueshme shtetërore për të dhënë modelin e artit elitë në shërbim të ideologjisë, ndërkohë që me një sy vigjilent ndiqte çdo rresht të krijimtarive.¹⁹

E megjithatë, funksionet në shtetin e kohës, dhe prania e ideologjisë në krijimtari, nuk arritën ta ulin fuqinë e sinqeritetit të frymëzimit artistik, duke mos arritur kështu të zbehin vlerat e artit të tyre, i cili u pëlqye në vitet për të cilat flasim, por që nxiti akoma edhe sot interesimin e vazhdueshëm të studiuesve e lexuesve për veprën e tyre. Kjo na kujton përcaktimin e teoricienëve R. Wellek, A. Warren, të cilët pohojnë se, *kuptimi plotë i një vepre arti nuk përcaktohet nga kuptimi që i kanë dhënë asaj autori dhe bashkëkohësit. Ky kuptim i plotë është më shumë rezultat i*

¹⁷ E. Faye, "Tri biseda me Kadarenë", f. 105. *Oh, sigurisht, kam besuar, kam besuar për një kohë të gjatë. Kam pasur një periudhë kur, si të gjithë në Shqipëri, besova te socializmi e komunizmi; sepse njihja botë tjetër përveç diktaturës socialiste. Isha shumë i ri kur zuri fill kjo gjë....lirinë e krijimit dhe jo lirinë e rëndomtë politike e kam pasur gjithnjë, dhe më ka mjaftuar të bëj çfarë kam bërë.*

¹⁸ *Oh, që ishim të mirë ne* (1968), vëllimi "Më vjen keq për Jagon" (1994), f. 23.

¹⁹ E. Faye, "Tri biseda me Kadarenë", Onufri, 2007, f. 57. E.F- gjatë periudhës së ndalim-botimit, a vazhdonit të ishit deputet? I. K- *Oh, s'isha më asgjë, kjo është për të qeshur...Si mund të jesh deputet kur nuk ke të drejtën e botimit? Qeshë deputet...ja kështu! Një ditë, në vitin 1970, pashë emrin tim në listën e deputetëve të rinj, ndërkohë që nuk dija asgjë. Qe më tepër një komedi, nuk isha një deputet i vërtetë.*

Polisemantika e shprehjes së figurshme të Arapit në krijimtarinë e tij...

*një, procesi rritjeje kuptimore, d.m.th., i përgjithësimit të atyre kuptimeve që ia ka zbuluar historia e kritikës dhe lexuesit e shumë epokave.*²⁰

Ka shkrimtarë që do të admirohen gjithmonë, por ka edhe nga ata të cilët i ndjek harresa. Gjykimi shoqërohet gjithmonë nga një dozë relativizmi të theksuar, por mes një poezie që i mbijetoi kohërave, këta poetë mbeten *flaka e vjetër* e një zjarri që nuk u shua dot.

²⁰ R. Welllek & A. Warren, *Teoria e letërsisë*, Onufri, 2007, f. 41.

IV

